

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXII, nr. 6770
E mërkurë, 30 nëntor 2022
çmimi 0.40

Vendimi për vizat, të mërkurën në rend dite

FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

SHUMË SHPEJT KUVENDIT I DËRGOHET PROJEKTLIGJI I RI PËR ZGJEDHJET E PËRGJITHSHME




Së shpejti pritet të draftohet Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme dhe do të dërgohet për miratim në Kuvend, ka thënë kryesuesi i Komisionit Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore, Abelard Tahiri. Sipas tij, zgjedhjet duhet të jenë të lira, të drejta dhe të qasshme për t'i

dhënë kuptim rrafshit elektoral të demokracisë. Tahiri ka theksuar se me këtë projektligj, përveç që është ruajtur baza e parimeve demokratike, sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës është avancuar e konsoliduar në shumë pikëpamje

KURTI PRET NË TAKIM RAPORTUESIN SPECIAL TË KOMBEVE TË BASHKUARA, DISKUTOJNË PËR KRIMET GJATË LUFTËS

FAQE 5



FSK-ja PËRFUNDON ME SUKSES USHTRIMIN FUSHOR "UJKU I NËNTORIT"

FAQE 7

AKTUALE



UASHINGTONI PLANIFIKON NDIHMË NDAJ UKRAINËS PËR INFRASTRUKTURËN E ENERGJISË

F. 2

ROHDE: GJERMANIA MBËSHTET SYNIMIN E KOSOVËS PËR ANËTARËSIM NË KËSHILL TË EVROPËS

F. 4

REFUZOHET MOCIONI I MBROJTJES SË THAÇIT PËR MUNDËSI HETIMORE UNIKE PËR TETË DIPLOMATËT

F. 5

EKONOMI



MBI 65 MILIONË EURO FITUAN BANKAT NË KOSOVË NË GJYSMËN E PARË TË VITIT 2022

F. 8

PËR DHJETË MUAJ QYTETARËT E KOSOVËS HARXHUAN 42 MILIONË EURO NË VETURA

F. 8

SPORT



KUPA E BOTËS: ANGLI - SENEGAL DHE HOLANDË - AMERIKË

F. 10

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepçishtë - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Uashingtoni planifikon ndihmë ndaj Ukrainës për infrastrukturën e energjisë

UASHINGTON, 29 NËNTOR - Forcat ruse kanë vazhduar ta bombardojnë infrastrukturën dhe ndërtesat civile në Ukrainë teksa luftimet në pjesën lindore kanë vazhduar edhe të martën, kanë thënë zyrtarë ushtarakë dhe rajonalë. Disa burime në Uashington kanë thënë se Shtetet e Bashkuara do të bëjnë të ditur ndihmën e re për Ukrainën, sidomos për rregullimin e infrastrukturës së energjisë, e cila është dëmtuar rëndë në javët e fundit si pasojë e sulmeve ruse. Qyteti i Dnjipros ka qenë shënjestër e sulmeve të natës së mbrëmshme, ka thënë guvernatori i rajonit Dnjipropetrovsk, Valentyn Reznichenko.

“Fabrikat e prodhimit janë shkatërruar. Ka pasur zjarr”, ka thënë ai, ndonëse nuk ka raportime për të plagosur. Forcat ushtarake ruse janë tërhequr nga rajoni i Lumit Dnjepër më herët gjatë këtij muaji, mirëpo kanë vazhduar të bombardojnë qyteza, fshatra dhe qytetin e Hersonit nga lokacionet e afërta. Presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky u ka bërë thirrje banorëve që të bëhen gati për ndërprerje të energjisë, teksa temperaturat sa shkojnë e ulen me afrimin e stinës së dimrit. Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt. Presidenti rus Vladimir Putin e konsideron luftën si “operacion special ushtarak”



për ta çmilitarizuar Ukrainën. Perëndimi është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur

ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur

mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

Të gjitha rajonet në botë “janë përballur me mot ekstrem këtë vit”



NJU-JORK, 29 NËNTOR - Të gjitha rajonet e botës janë përballur me mot ekstrem këtë vit, qoftë me vërshime ashtu edhe me thatësira - dhe miliarda njerëz nuk kanë pasur ujë të mjaftueshëm për pije, kanë thënë të martën Kombet e Bashkuara. Shumë rajone kanë regjistruar nivele rekorde të thatësisë më 2021 në krahasim me kushtet normale, ka thënë Agjencia e OKB-së për Motin në raportin e saj më të ri.

Në të janë vlerësuar efektet e këtyre ndryshimeve në klimë, ambient dhe shoqëri. “Ndikimi i ndryshimeve klimatike kryesisht vërehet përmes ujit - thatësitat janë më intensive dhe më të shpeshta, vërshimet janë të shkallës më ekstreme, duke prekur ekonominë, ekosistemet dhe të gjitha aspektet e përditshmërisë sonë”, ka thënë shefi i Agjencisë së OKB-së për Motin, Petteri Taalas. Rreth 3.6 miliardë njerëz përballen me kushte joadekuate

për qasje në ujë, të paktën një muaj gjatë vitit. Në periudhën 2001-2018, 74 për qind e të gjitha katastrofave natyrore kanë qenë të lidhura me ujin, sipas studimeve të OKB-së. Shkencëtarët tashmë kanë paralajmëruar për rritje të temperaturës së Tokës në 1.2 gradë celsius prej nisjes së epokës industriale. Temperaturat është thënë se do të vazhdojnë të rriten në rast se qeveritë nuk marrin masa për t'i ndaluar emetimet e karbonit.

Sunak: Ka përfunduar epoka e artë e marrëdhënies Britani - Kinë

LONDËR, 29 NËNTOR - Kryeministri britanik Rishi Sunak ka thënë se “epoka e artë” e marrëdhënies me Kinën ka përfunduar. Në fjalimin e tij të parë për politikën e jashtme, Sunak ka thënë se marrëdhëniet e ngushta ekonomike me Kinën në dekadën e fundit përbëjnë naivitet. Sipas tij, është koha që Mbretëria e Bashkuar ta zëvendësojë shprehjen me “pragmatizëm” për t’u qasur

konkurrencës. Megjithatë, Sunak ka paralajmëruar kundër “retorikës së Luftës së Ftohtë”, duke shtuar se ndikimi global kinez nuk mund të injorohet. Ai është përballur me presion për ta ashpëruar qasjen ndaj Kinës, prej kur ka ardhur në pushtet muajin e kaluar. Fjalimi i tij është mbajtur teksa në Kinë është protestuar kundër ligjeve strikte për menaxhim të



pandemisë së koronavirusit. Të martën ka raportime se autoritetet mund t’i kenë shtypur tërësisht protestat për shkak të pranisë së madhe të zyrtarëve

policorë nëpër qytete. Kina zbaton politikën e zero rasteve me koronavirus, që parasheh karantina të gjata dhe testim të shpeshta. Ajo është ndër vendet e fundit në botë që praktikon masa të tilla për menaxhim të këtij virusi. Për koronavirusin e ri, që shkakton sëmundjen Covid-19, është raportuar për herë të parë në dhjetor të vitit 2019 në Vuhan të

Kinës. Organizata Botërore e Shëndetësisë e pati shpallur koronavirusin pandemi më 11 mars të vitit 2020. Më shumë se 6.5 milionë njerëz kanë vdekur prej shpërthimit të pandemisë në gjithë botën. Shtetet e Bashkuara kanë regjistruar numrin më të madh të viktimave, të përcjella nga India dhe Brazili.

Shpërthen vullkani më i madh aktiv në botë

Honolulu, 29 nëntor - Vullkani më i madh aktiv në botë, Mauna Loa, ka shpërthyer për herë të parë pas gati 40 vjetësh. Ky vullkan gjendet në Havai - territor amerikan. Llava është lokalizuar në

perimetrin e parashikuar, mirëpo banorët e zonave në afërsi janë paralajmëruar për rrezikun e hirit vullkanik. Shërbimi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara ka thënë se situata mund të ndryshojë

shumë shpejt. Vullkani Mauna Loa gjendet 4.169 metra mbi nivelin e detit dhe zgjerohet në një territor prej mbi 5.179 kilometrash. Aktivizimi i vullkanit vjen pas disa tërmeteve që janë

raportuar në këtë rajon prej ditës së diel. Sipas autoriteteve amerikane, Mauna Loa ka shpërthyer 33 herë prej vitit 1843. Shpërthimi i fundit i madh është raportuar më 1984.



Vendimi për vizat, të mërkurën në rend dite



Prishtinë, 29 nëntor - Miratimi i vendimit për liberalizimin e vizave për Kosovën pritet të jetë të mërkurën në rend dite në takimin e ambasadorëve të BE-së në Bruksel.

Në takimin e këtij grupi, i njohur si Coreper, vendimi pritet të miratohet pa diskutim, pasi për tekstin e tij vendet anëtare të BE-së janë pajtuar më 22 nëntor, në një takim të këshilltarëve për çështje të brendshme dhe drejtësi.

Teksti është përpiluar nga Çekia, e cila ka udhëheqjen aktuale të BE-së, pas disa takimeve të grupeve punuese dhe diskutimeve dypalëshe me vendet që kanë pasur vërejtje.

Sipas versionit të fundit, në të cilin ka pasur qasje "Radio Evropa e Lirë", lëvizja pa viza për qytetarët e Kosovës do të jetë e mundur kur të hyjë në fuqi sistemi evropian i udhëtimit, ETIAS, dhe data për këtë është 1 nëntori i vitit 2023. Por, në rast se do të ketë vonesa për këtë sistem, liberalizimi i vizave për Kosovën do të hyjë në fuqi jo më vonë se më 1 janar të vitit 2024.

Deri atëherë Kosova duhet të synojë të ketë "marrëveshje apo aranzhime" për riadhesim me ato vende të BE-së me të cilat nuk i ka.

Kosovës, po ashtu, i kërkohet të vazhdojë ta përshtatë politikën

e saj të vizave me atë të BE-së, ndërkohë që i mbetet të kalojë edhe nëpër disa procedura të tjera që i kërkojnë vendet anëtare.

Vendimi që do të dalë të mërkurën në rend dite, ka qenë fillimisht i paraparë të votohet më 23 nëntor.

Ai është hequr nga agenda për shkak të tensioneve në Kosovë që ka nxitur një vendim i qeverisë së vendit për t'i reregjistruar makinat me targa të paligjshme serbe. Ndërkohë, Kosova dhe Serbia, me ndërmjetësimin e BE-së, kanë arritur marrëveshje për çështjen e targave.

Krahas tekstit për liberalizimin

e vizave për Kosovën, Çekia ka bërë edhe një deklaratë, me të cilën vendeve anëtare të BE-së u kërkohet që të bëjnë çmos që sistemi ETIAS të jetë funksional në datën e caktuar, përkatësisht më 1 nëntor të vitit të ardhshëm.

ETIAS kërkon që qytetarët e huaj, të cilët udhëtojnë pa viza në territorin e BE-së, t'i regjistrojnë të dhënat e tyre në këtë sistem para udhëtimit.

Franca ka qenë shteti që ka këmbëngulur më së shumti që hyrja në fuqi e liberalizimit të vizave për Kosovën, të lidhet me funksionalizimin e ETIAS-it, duke thënë se ai është i rëndësishëm për rritjen e

sigurisë së vendeve anëtare.

Liberalizimi i vizave do t'u mundësojë qytetarëve të Kosovës të udhëtojnë lirshëm në atë që njihet si zona Schengen, e që përbëhet prej 26 shtetesh evropiane.

Kosova, aktualisht, është vendi i vetëm në Ballkanin Perëndimor, qytetarët e të cilit nuk mund të lëvizin lirshëm në këtë zonë. Kjo, përkundër faktit se Komisioni Evropian, qysh në vitin 2018, ka konfirmuar disa herë se Kosova i ka përmbushur të gjitha kushtet për liberalizimin e vizave, por kanë qenë disa vende anëtare që vazhdimisht kanë shprehur rezerva.

PDK-ja kërkon unitet për Projektligjin për Pensionet e Policëve

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Partia Demokratike e Kosovës (PDK) ka kërkuar mbështetjen e të gjithë deputetëve për ta votuar Projektligjin për Pensionet e Zyrtarëve Policorë të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me autorizime policor.

Pas marrjes së pëlqimit nga Komisioni për Çështje të Sigurisë dhe Mbrojtjes, propozuesja e këtij Projektligji, deputetja e PDK-së, Ganimete Musliu, i ftoi të gjithë ekspertët e fushës që të kontribuojnë. Në një konferencë për medie,

Musliu tha se shpreston që në seancën e Kuvendit, në të cilën do të diskutohet për këtë Projektligj, të mos ketë debate pozitive-opozitive, por vetëm debate konstruktive e përmbajtjesore të cilat do të ndihmojnë Policinë e Kosovës sepse, sipas saj, siguria e vendit nuk i takon asnjë partie politike. "Ftoj të gjithë ekspertët dhe njohësit e fushës që të bëhen pjesë e këtij ligji në mënyrë që ta kemi një ligj sa më të mirë për pensionimin e policëve të Kosovës, një ligj të implementueshëm, i cili i

garanton pensionim të dinjitetshëm Policisë së Kosovës", u shpreh ajo.

Ndërsa deputeti i PDK-së, Rashit Qalaj, ka thënë se janë të gatshëm që brenda afateve kohore ndërmjet dy leximeve, t'i presin komentet, qoftë nga sindikatat, ekspertët apo nga kushdo qoftë.

Për kalimin në lexim të parë të këtij Projektligji u deklarua edhe deputeti tjetër i PDK-së, Hisen Berisha, i cili tha se është domosdoshmëri që të ketë ligj për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë.





Refuzohet mocioni i mbrojtjes së Thaçit për mundësi hetimore unike për tetë diplomatët

HAGË, 29 NËNTOR - Gjykatësi i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka marrë vendim me të cilin ka refuzuar mocionin e mbrojtjes së Hashim Thaçit, ku ishte kërkuar mundësi hetimore për dëshmitarët ndërkombëtarë, pasi kishte vlerësuar se dëshmitë e tyre janë të rëndësishme për çështjen.

Steve Bennet, Wesley Clark, Jock Dovey, Michael Durkee, Daan W. Everts, Bernard Kouchner, William Walker dhe një diplomat tjetër që i është redaktuar emri, janë dëshmitarët për të cilët mbrojtja e ish-presidentit Thaçi kërkoj mundësi hetimore unike.

Në fillim thuhet se gjykatësi paraprak kujton se rregulli 99 i Rregullave parashikon se hetimi duhet të paraqesë një mundësi unike sepse provat mund të mos jenë të disponueshme më pas në gjyq. Në përputhje me këtë, thuhet se testi ligjor sipas dispozitës konsiston në disponueshmërinë e një akti hetimor që paraqet një mundësi unike për të siguruar prova që mund të mos jenë në dispozicion më pas në gjyq.

Vendimi thotë se gjykatësi paraprak vëren se një vlerësim nëse provat mund të "mos jenë të disponueshme më pas në gjyq" është një që kryhet rast pas rasti dhe përfshin shqyrtimin e faktorëve të tillë si, ndër të tjera, kalimin e kohës, shëndetin ose

gjendjen fizike të një dëshmitari, qasja e përkohshme në sendin evidentues, ose presioni i ushtruar mbi një dëshmitar.

Përveç testit ligjor të sipërpërmendur, vendimi thotë se gjyqtari paraprak është i mendimit se rregulli 99 i Rregullave nënkupton se akti i kërkuar hetimor duhet të jetë i rëndësishëm për përgatitjen e çështjes së palës që kërkon. Së fundi, thuhet se masat e marra në përputhje me rregullat 99 dhe 100 të Rregullave nuk i pengojnë palët të kërkojnë më pas pranimin në gjykim të deklaratave ose transkripteve të mëparshme me shkrim në përputhje me Rregullat 153 deri në 155 të Rregullave. "Në lidhje me argumentet e Mbrojtjes Thaçi lidhur me Dëshmitarët ("mosha e avancuar" dhe "shkallë të ndryshme të shëndetit"), gjykatësi paraprak vëren se dëshmitarët janë midis 77 dhe 87 vjeç. Megjithatë, asgjë në mocion apo shtesë nuk tregon se gjendja shëndetësore e dëshmitarëve tani është një shqetësim serioz që do të garantonte ruajtjen e menjëhershme të provave të tyre. Përkundrazi, gjykatësi paraprak vëren se mbrojtja e Thaçit pranon se shëndeti i dobët ose i keq i dëshmitarëve 'nuk është aktualisht një faktor'. Siç ka pranuar mbrojtja e Thaçit, vetëm mosha është një arsye e pamjaftueshme për të besuar se

provat e një dëshmitari mund të bëhen të paarrtshme", thotë vendimi.

Lidhur me kohëzgjatjen e parashikuar të kohës përpara se të fillojë çështja e mbrojtjes, gjykatësi paraprak thuhet se kujton se ai do ta transmetojë çështjen në një panel gjyqësor deri në fund të vitit 2022. "Nga kjo rrjedh se trupi gjykues, në çdo rast, do të ngarkohet me procedurat në këtë rast shumë përpara se Masa e Parë e parashikuar nga Mbrojtja Thaçi në shkurt 2023 të zbatohet realisht, nëse masa e parë jepet. Prandaj, duke pasur parasysh transmetimin e menjëhershëm të çështjes në gjyq dhe caktimin e ardhshëm të një paneli gjyqësor, gjykatësi paraprak është i mendimit se vlerësimi i rëndësisë, nevojës dhe caktimit të dëshmisë së dëshmitarëve është një çështje që vendoset më mirë nga paneli gjyqësor që do të caktohet për ta dëgjuar çështjen", thuhet tutje në këtë vendim.

Në këtë mënyrë gjykatësi paraprak gjen se Mbrojtja Thaçi nuk ka mbështetur kërkesën e saj për një mundësi unike hetimi dhe refuzon kërkesën për Masën e Parë. "Duke thënë këtë, ky vendim është pa paragjykim ndaj çdo paraqitjeje të ardhshme të një Paneli Gjyqësor të ngarkuar me këtë rast në lidhje me modalitetet, kohën dhe kronologjinë e dëshmisë së dëshmitarëve. Prova

ligjore sipas rregullit 100 të Rregullave për marrjen e një depozitimi për përdorim në gjyq është nëse 'ka një arsye për të besuar se provat e dëshmitarit të mundshëm mund të bëhen përndryshe të padisponueshme', thuhet në këtë vendim.

Për arsyet e përcaktuara më sipër, vendimi thotë se gjykatësi paraprak nuk bindet se mosha e shkuar dhe shkalla e ndryshme e shëndetit të dëshmitarëve dhe kohëzgjatja e parashikuar e kohës para se të dëgjohet çështja e mbrojtjes, përbëjnë, në këtë fazë, një arsye për të besuar se dëshmitë e dëshmitarëve në të kundërt mund të bëhen të paarrtshme brenda kuptimit të Rregullit 100 të Rregullave. Në këtë mënyrë, gjykatësi paraprak kundërshton kërkesën për masën alternative. Gjykatësi paraprak kujton se mbrojtja e Thaçit nuk është e përjashtuar nga bërja e paraqitjeve në lidhje me dëshmitarët në panelin përkatës gjyqësor, nëse ajo zgjedh.

Paraprakisht, në vendim thuhet se sa i përket argumentit të ZPS-së, se shtesa e mocionit duhet të refuzohet pasi është paraqitur jashtë kohës, gjykatësi paraprak kujton se ai urdhëroi ekipet e mbrojtjes të paraqesin çdo kërkesë që justifikonte nevojën për çdo mundësi hetimi në zbatim të rregullit 99 të Rregullave deri më 28 tetor 2022. Gjykatësi paraprak thuhet se vëren se Mbrojtja e Thaçit paraqiti sht-

esën më 11 nëntor 2022 pa asnjë kërkesë për ta ndryshuar afatin kohor. "Po ashtu, gjykatësi paraprak vëren se Mbrojtja e Thaçit, (i) njoftoi për qëllimin e saj për të kërkuar masa në zbatim të rregullit 100 të Rregullave në lidhje me nëntë individë që nga paraqitja e lajmërimit të saj më 7 tetor 2022; (ii) shpjegoi se, në datën e paraqitjes së Mocionit, "për arsye përtej kontrollit të tij" ajo ishte në gjendje vetëm të aplikonte për masa në lidhje me vetëm tetë dëshmitarë dhe (iii) shpjegoi se, në kohën e paraqitjes së shtesës, sapo kishte marrë autorizim nga autoritetet përkatëse, tani ishte në gjendje të aplikonte për masat për këtë dëshmitar të nëntë të cilit fillimisht i ishte referuar në Njoftim", thuhet në këtë vendim.

Tutje, thuhet se për më tepër ZPS nuk është e paragjykuar duke pasur parasysh se ishte: (i) në njoftim të qëllimit të mbrojtjes Thaçi për të kërkuar masa për nëntë dëshmitarë; dhe (ii) në gjendje të përgjigjet plotësisht ndaj shtesës. Në këtë mënyrë thuhet se gjykatësi i paragjykatës kundërshton parashtrësat e ZPS-së lidhur me këtë. Dhe se ai pranon paraqitjen me vonesë të shtesës.

Ndryshe, më 28 tetor 2022 mbrojtja e Thaçit paraqiti një mocion që justifikonte nevojën për masat e kërkuara për tetë dëshmitarë në kontekstin e një mundësie unike hetuese. /BetimipërDrejtësi/

Shumë shpejt Kuvendit i dërgohet projektligji i ri për zgjedhjet e përgjithshme

Së shpejti pritet të draftohet Ligji për Zgjedhje të Përgjithshme dhe do të dërgohet për miratim në Kuvend, ka thënë kryesuesi i Komisionit Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore, Abelard Tahiri. Sipas tij, zgjedhjet duhet të jenë të lira, të drejta dhe të qasshme për t'i dhënë kuptim rrafshit elektoral të demokracisë. Tahiri ka theksuar se me këtë projektligj, përveç që është ruajtur baza e parimeve demokratike, sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës është avancuar e konsoliduar në shumë pikëpamje

**EPOKA
ERE**

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Komisioni Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore në Kosovë ka mbajtur punëtorinë e fundit në të cilën kanë marrë pjesë zyrtarë nga KQZ-ja, OSBE-ja dhe përfaqësues nga ambasadat e huaja. Në këtë mbledhje janë paraqitur edhe diskutimet e rekomandimeve të KQZ-së në Komisionin Ad-Hoc të Kuvendit. Kryetari i Komisionit Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore në Kosovë, Abelard Tahiri, ka thënë se konsensusi brenda partive ekziston dhe se janë të gatshëm që së shpejti draftin ta dërgojnë për në Kuvend. "Zgjedhjet nuk janë thjesht procedurë, por edhe mjet i formimit të vullnetit politik të qytetarëve. Prandaj, ato duhet të jenë të lira, të drejta dhe të

qasshme për t'i dhënë kuptim rrafshit elektoral të demokracisë. Si kryetar i Komisionit Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore jam i lumtur që së bashku me anëtarët e komisionit dhe partnerët tanë ndërkombëtarë po punojmë për standarde të tilla zgjedhore dhe jemi duke shkuar drejt finalizimit të procesit të kësaj reforme. Shumë shpejt Kuvendit do t'ia dërgojmë projektligjin e ri, në të cilin, përveç që është ruajtur baza e parimeve demokratike, sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës është avancuar e konsoliduar në shumë pikëpamje, në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira demokratike", ka thënë Tahiri.

Nënkryetari i këtij Komisioni, Adnan Rrustemi, ka theksuar se Kosova ka shënuar përparim për organizmin e zgjedhjeve nga viti



në vit, por rekomandimet e dhëna kanë treguar se ka hapësirë për përmirësim. "Komisioni Ad-Hoc i themeluar nga Kuvendi i Kosovës si rrjedhojë e deklaratave të nënshtruara nga përfaqësuesit e partive politike ka një mandat që buron nga kjo deklaratë dhe ka për qëllim përmirësimin dhe forcimin e procesit zgjedhor duke marrë shkas nga rekomandimet e Misionit të Vëzhguesve të BE-së, pa u kufizuar në këto

rekomandime, por që gjithsesi në funksion të procesit të organizimit të zgjedhjeve", është shprehur ai. Shefi i Misionit i OSBE-së në Kosovë, Michael Davenport, ka thënë se janë të gatshëm ta ndihmojnë Komisionin Ad-Hoc për Reformën Zgjedhore për këtë çështje, duke e përgëzuar atë për punën e bërë. "Kjo tregon përkushtimin e komisionit Ad-Hoc për të shtyrë këtë proces

përpara në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të plotë. Besoj se Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë ofron një bazë të mirë për mbajtjen e zgjedhjeve demokratike, pra një mundësi për të forcuar këtë kornizë ligjore dhe për ta ofruar edhe më shumë në standardet ndërkombëtare për zgjedhjet", ka deklaruar Davenport. Kjo punëtori është mbështetur nga Misioni i OSBE-së në Kosovë.



Rohde: Gjermania mbështet synimin e Kosovës për anëtarësim në Këshill të Evropës

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Jorn Rohde, ka thënë se Berlioni zyrtar mbështet plotësisht synimin e Kosovës për

anëtarësim në Këshillin e Evropës. Këtë deklaratë Rohde e ka bërë pas takimit që ka pasur të martën bashkë me zyrtarë të Këshillit të Evropës me

deputetë të Kuvendit të Kosovës. "Unë nënvizova mbështetjen e plotë të Gjermanisë për Republikën e Kosovës në synimin për anëtarësim në Këshill të

Evropës", ka shkruar Rohde në "Twitter". Pjesë e këtij takimi kanë qenë deputetët Arben Gashi, Enis Kervan, Ariana Shoshi dhe Besnik Tahiri.



Ka nisur iniciativa për rivitalizimin praktik të trashëgimisë kulturore folklorike



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ministria e Kulturës para disa muajsh ka ftuar një grup të profesionistëve, komision i kryesuar nga Ansambli "Shota", të cilëve ua ka mandatuar analizimin dhe propozimin e një plani të zhvillimit të mëtutjeshëm praktik të trashëgimisë muzikore folklorike.

Ansambli "Shota" në Muzeun Kombëtar të Kosovës ka mbajtur ceremoni dhe performancë për të paraqitur këtë platformë. Përmes saj parashihet që në një të ardhme të afërt të krijohet Orkestra Folklorike Simfonike, gjithashtu aktivitete që përfshijnë performanca, program dhe

edukim në instrumente folklorike. Në këtë ngjarje ishte i pranishëm ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku, drejtori artistik i Ansambli "Shota", Ylber Hasanaj, pjesëmarrës të tjerë të fushës, ndërsa prezantimin e planit e bëri Visar Munishi, kompozitor dhe profesor në UP.

Del në diskutim publik projektplanin e punës së kryetarit të Prizrenit për vitin 2023

PRIZREN, 29 NËNTOR - Në sallën e mbledhjeve të Kuvendit Komunal të Prizrenit është mbajtur konsultim publik me qytetarë për projektplanin e punës së kryetarit të komunës së Prizrenit për vitin 2023, organizuar nga anëtarët e grupit punues për hartimin e planit. Ymer Berisha, udhëheqës i Njësisë për Komunikim me Publikun, bëri hapjen e këtij konsultimi dhe theksoi se për herë të parë është duke u mbajtur një konsultim i tillë për planin e punës së kryetarit sipas kërkesave ligjore për hartim dokumenteve komunale.

Dokumenti është fleksibil deri në datën e miratimit të tij në Kuvend, andaj i ftoi të pranishmit dhe qytetarët e tjerë të japin propozime apo sugjerime. Plani ka dalë në konsultim publik me kohë dhe komentet për këtë plan qytetarët mund t'i japin edhe gjatë ditëve në vijim. Bashkim Gashi, qytetar, ka kërkuar që në projektet e

Drejtorisë për Shërbime Publike të parashihet rregullimi i pjerrinave në institucione publike si dhe në ato private për persona me aftësi të kufizuar; rregullimi i rrugës që dërgon për në kalanë e qytetit; krijimi i mekanizmave për rritjen e transparencës; kujdes më të madh në matjen dhe rritjen e performancës.

Ndërsa Flaka Bamja-Bytyqi nga zyra informative për turizëm ka kërkuar që të përfshihet në Drejtorinë e Turizmit rregullimi i inventarit të zyrës informative si dhe punëtorët e kësaj zyre të hyjnë në listë të pagave të zyrtarëve komunalë.

Hazir Krasniqi, përgjegjës për konsultime publike në komunën e Prizrenit, ka folur për publikimin e planit që ka dalë në konsultim publik në uebfaqe si dhe në platformën e konsultimeve publike më 16.11.2022 dhe në konsultim publik do të jetë deri më 16.12.2022.



Hamza pret në takim ambasadorin e Tajvanit, Shih-Chung Liu



MITROVICË, 29 NËNTOR - Kryetari i komunës së Mitrovicës, Bedri Hamza, ka pritur në takim përfaqësuesin e Tajvanit në Hungari, ambasadorin Shih-Chung Liu.

Në këtë takim është biseduar për mundësitë e bashkëpunimit në mes të komunës së Mitrovicës dhe qyteteve të Tajvanit si dhe shkëmbimi i përvojave ndërmjet qyteteve, sidomos në fushën e "Smart city".

Ata kanë diskutuar edhe për krijimin e një platforme për ngritjen e kapaciteteve të stafit të

komunës përmes trajnimeve nga ekspertë të Tajvanit. Po ashtu, gjatë takimit është bërë me dije se studentët e Mitrovicës nga viti i ardhshëm do të kenë mundësi që të jenë pjesë e një platforme të bursave për të studiuar në Tajvan.

Me këtë rast, kryetari Hamza ka falënderuar ambasadorin Liu-n për vizitën e realizuar në komunën e Mitrovicës, duke theksuar se Tajvani është lider botëror në industrinë e IT-së dhe një ndër fuqitë më të mëdha të ekonomisë botërore.

Në Kompleksin "Adem Jashari" hapet ekspozita "Të ndarë, por të pashkëputur"

SKENDERAJ, 29 NËNTOR - Në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz është hapur ekspozita "Të ndarë, por të pashkëputur", organizuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të

Arkivave të Shqipërisë.

Kjo ekspozitë përmban 25 pano me dokumente, fotografi dhe shkrime gazetash të kohës, për ngjarje dhe aktivitete të ndryshme që, në thelb, kishin veprimtarinë patriotike shqiptare, duke filluar prej kohës

së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit e deri në ditët tona. Përmes tyre pasqyrohet rrugëtimi dhe kontributi i personaliteteve shqiptare drejt lirisë dhe shtetformimit.

Ekspozitën e vizitoi edhe ministri i Kulturës, Hajrulla Çeku.



Policia e Kosovës do ta rrisë bashkëpunimin me Policinë e Izraelit

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ushtruesi i detyrës i drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Kosovës, Fehmi Hoti, i shoqëruar nga drejtori i Divizionit për Hetimin e Krimeve, Fatos Makolli, po marrin pjesë në Konferencën Ndërkombëtare të Komisionarëve dhe Ekzekutivëve të LEA-s e cila po zhvillohet në Izrael.

Në kuadër të kësaj vizite u realizuan takime të niveleve të larta, ndër to edhe takimi

bilateral i realizuar me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Izraelit, Yaakov Shabtai, me të cilin u diskutuan tema mjaft të rëndësishme në interes të organizatave policore.

Policia e Kosovës ka njoftuar se ky takim kishte për qëllim ta rrisë bashkëpunimin dhe avancimin drejt shkëmbimit të informacioneve, ofrimin e trajnimeve dhe përvojave më të mira ndërkombëtare në interes të organizatës

policore, të cilat shërbejnë në zhvillimin dhe avancimin profesional të policisë dhe në luftimin e krimit të organizuar dhe kërcënimeve ndërkombëtare. U. d. drejtori Hoti ka falënderuar drejtorin e Policisë së Izraelit, Yaakov Shabtai, për pritjen e tij, për përkrahjen dhe mbështetjen për realizimin e kësaj vizite mjaft të rëndësishme për Policinë e Kosovës.



FSK-ja përfundon me sukses ushtrimin fushor "Ujku i nëntorit"



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Forca e Sigurisë së Kosovës (FSK) me sukses ka përfunduar ushtrimin fushor "Ujku i nëntorit" në poligonin e stërvitjes në Babaj të Bokës në komunën e Gjakovës.

Qëllimi i këtij ushtrimi ishte validimi i njësive të manovrës dhe mbështetjes në nivel kompanie si dhe njësitë e rikonicionit në nivel togu, mbështetur me një togë mjekësore (Rol 1) nga Regjimenti i Mjekësisë së Komandës së Logjistikës.

Pjesë e këtij ushtrimi ishin Regjimenti i Parë dhe i Dytë i Komandës së Forcave Tokësore (KFT), një togë mjekësore ROL 1 nga Regjimenti i Mjekësisë së Komandës së Logjistikës dhe Regjimenti i Tretë i KFT-së në rolin e forcës opozitare.

Për ta parë nga afër realizimin praktik në përmblyllje të ushtrimit ishte zëvendëskomandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralmajor Enver Cikaqi, shef i stafit të Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralbrigade Jeton Dreshaj, drejtori i NALT-it,

gjeneralbrigade Joachim Hoppe, zëvendës-komandanti i Komandës së Forcave Tokësore, kolonel Hysen Dreshaj, zëvendëskomandanti i Komandës së Logjistikës, kolonel Avdi Raci, oficerë e nënoficerë të FSK-së e NALT-it. Në ceremoninë e përfundimit zëvendëskomandanti i FSK-së gjeneralmajor Enver Cikaqi i përgëzoi ushtarakët për realizimin e këtij ushtrimi fushor jashtëzakonisht të rëndësishëm për FSK-në. "Secili prej nesh kemi familjet tona, por familja jonë e madhe është Forca e Sigurisë së Kosovës, ne jemi vëllezër dhe motra në armë që i shërbejmë kësaj familje, andaj dojeni njëri-tjetrin, përkrahni njëri-tjetrin, mbështeteni njëri tjetrin në mënyrë që të jemi sa më të përgatitur që në ditët dhe momentet më të vështira t'i qëndrojmë njëri-tjetrit përkrah", ka thënë Cikaqi.

Niveli i suksesit të këtij ushtrimi fushor është treguesi më i mirë i ngritjes së zhvillimit profesional të pjesëtarëve të FSK-së dhe kapaciteteve operacionale.

Kurti pret në takim raportuesin special të Kombeve të Bashkuara, diskutojnë për krimet gjatë luftës

EPOKA ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Angazhimi i qeverisë për adresimin e krimeve të kryera gjatë luftës në Kosovë dhe nismat për drejtësi tranzicionale ishin temat e takimit të kryeministrit Albin Kurti me Fabian Savioli, raportuesin special të Kombeve të Bashkuara për promovimin e së vërtetës, drejtësisë, reparacioneve dhe garantimit të mospërsëritjes. Savioli ka shprehur mirënjohjen për bashkëpunimin e treguar nga qeveria dhe institucionet e Republikës së Kosovës dhe shprehur solidaritetin me viktimat dhe popullin e Kosovës.

Kryeministri Kurti ka theksuar përkushtimin e Qeverisë së Kosovës për ballafaqim me të kaluarën dhe për drejtësi. Ai ka thënë se na duhet të ketë



rehabilitim dhe rivendosi të drejtësisë për viktimat e të mbijetuarat/it, pasi është shumë e vështirë për familjet të

vazhdojnë të jetojnë normalisht pavarësisht prej humbjeve dhe vuajtjeve të tyre.

Kurti ka veçuar disa nga nismat e

Qeverisë së Kosovës, si ajo për themelimin e Institutit për Krimet e Kryera Gjatë Luftës, hartimin e Strategjisë Kombëtare për

Drejtësi Tranzicionale, si dhe fuqizimin e Departamentit të Krimeve të Luftës në Prokurorinë Speciale të Kosovës.

Po ashtu, foli edhe për ndryshimet e bëra në Kodin e Procedurës Penale të cilat mundësojnë gjykimin në mungesë për raste të krimeve të luftës, duke qenë se shumica e kryerësve të krimeve të luftës në Kosovë ndodhen në Serbi dhe Serbia refuzon t'i dorëzojë ata para drejtësisë.

Kryeministri Kurti ka theksuar çështjen e të zhdukurve me dhunë gjatë luftës dhe familjet që jetojnë në dhembje e ankth, duke mos ditur për fatin e vendndodhjen e të dashurve të tyre. Ai ritheksoi domosdoshmërinë e hapjes së arkivave shtetërore në Serbi, pasi krimet e kryera në Kosovë ishin krime të kryera nga shteti i Serbisë.

Për dhjetë muaj qytetarët e Kosovës harxhuan 42 milionë euro në vetura



PRISHTINË, 29 NËNTOR - 2 694 vetura janë importuar në Kosovë gjatë periudhës janar - tetor të këtij viti. Vlera e këtyre veturave kap shumën e 42 milionë eurove. Kështu ka thënë për "Klankosova.tv" zëdhënësi i Doganës së Kosovës,

Adriatik Stavileci. Sipas tij, shteti ka përfituar 8.5 milionë euro taksa nga këto importime. "Gjatë periudhës janar-tetor janë importuar 2 694 vetura të reja. Vlera e tyre është rreth 42 milionë euro, derisa taksat janë rreth 8.5 milionë të arkëtuara", ka

thënë Stavileci. Ai ka theksuar se veturat e blera nga qytetarët e Kosovës vijnë kryesisht nga vendet evropiane. "Kryesisht janë brendet evropiane me origjinë nga Gjermania, Franca, Rumania", ka deklaruar Stavileci.

Mbi 65 milionë euro fituan bankat në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 2022

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Bankat komerciale në Kosovë në gjysmën e parë të vitit 2022 kanë realizuar fitim në vlerë prej 67.5 milionë eurosh, vlera më e lartë e regjistruar që nga themelimi i sektorit bankar për periudhën e gjashtëmuajorit të parë.

Kështu është thënë në raportin e Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) mbi vlerësimin tremujor të ekonomisë për periudhën janar - qershor 2022.

Ky rezultat financiar i atribuohet rritjes më të lartë të të hyrave, mbështetur nga rritja e përshpejtuar e kreditimit, njëkohësisht rritjes më të ulët të shpenzimeve. "Gjithsej të hyrat arritën vlerën prej 168.9 milionë eurosh, që paraqet një rritje vjetore prej 11.6-përqindësh (11.1 për qind një vit më parë). Në rritjen e të hyrave kontributin kryesor kishin të hyrat nga interesi, që përfaqësojnë 71.2 për qind të gjithsej të hyrave. Në kuadër të hyrave nga interesi arkëtimet nga interesi në kredi kishin kontributin kryesor në këtë rritje, kategori e ndikuar prej rritjes së theksuar të kreditimit. Për dallim nga periudhat e kaluara, me rritje mjaft të lartë u karakterizuan të hyrat nga interesi prej mjeteve të mbajtura në bankat e tjera, që



mund të jenë ndikuar nga rritja e normave të interesit në depozita. Përderisa kategoria e të hyrave nga jointerisi shënoi rritje më të ngadalësuar

krahasuar me një vit më parë, prej 13.3-përqindësh (23.9 për qind në qershor 2021) dhe arritën në vlerën prej 42.1 milionë eurosh, kryesisht

rezultat i arkëtimeve nga tarifat dhe komisionet", është thënë në raportin e BQK-së. Për dallim nga viti i kaluar, gjithsej shpenzimet e sektorit

bankar janë rritur 6.1 për qind deri në qershor 2022 (rënie prej 1.1-përqindësh në qershor 2021) dhe kanë arritur vlerën prej 101.4 milionë eurosh.

Brenda një jave KEDS-i zë 164 konsumatorë duke vjedhur energjinë elektrike



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Planet dhe aksionet për kontrolle të keqpërdorimeve të ekipeve të Departamentit të Humbjeve në Kompaninë Kosovare për Distributim me Energji Elektrike në Kosovë (KEDS) vazhdojnë të zbatohen në tërë Kosovën në baza ditore.

"Vetëm gjatë javës së kaluar në të gjitha distriktet dhe nëndistriktet janë kryer 1 976 kontrolle të konsumatorëve të energjisë elektrike, për të cilët dyshohej se po keqpërdorin rrymën. Prej tyre 164 u vërtetua se po e anashkalonin matjen e saktë të energjisë

elektrike", ka njoftuar KEDS-i, duke njoftuar se keqpërdorimi i energjisë elektrike është i papranueshëm dhe i dënueshëm. "Rastet e tilla ekipet e KEDS-it do t'i parashtrajnë për procedura të mëtutjeshme gjyqësore", është theksuar në njoftimin e KEDS-it.

Qeveria planifikon t'i emërojë shtatë atashe ekonomike në vitin 2023

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë ka planifikuar që në vitin 2023 të emërojë shtatë atashe ekonomike. Ministria e kësaj ministrie, Rozeta Hajdari, gjatë raportimit në Komisionin Parlamentar për Ekonomi,

ka thënë se me planifikim buxhetor për vitin 2023 është paraparë emërimi i shtatë atasheve ekonomike. Hajdari ka thënë se diplomacia ekonomike do të jetë prioritet për vitin e ardhshëm, siç tha ajo, për promovim dhe nxitje të

investimeve në Kosovë. Në këtë komision ministria Hajdari ka theksuar se rezerva shtetërore është rritur shumëfish më shumë për vitin 2023 krahasuar me vitet paraprake. Kjo rezervë, sipas saj, do të jetë në vlerë 15 milionë euro.



Organizimi i shtetit shqiptar për pritjen e refugjatëve nga Kosova



Prof. asoc. dr. Ardit BIDO

Lëvizja e popullsisë shqiptare e Kosovës filloi në mënyrë të organizuar duke filluar nga marsi i vitit 1999 për shkak të shumë faktorëve e që më kryesorët ishin dhuna dhe represioni serb. Shumë familje kishin lëvizur më herët nga Kosova dhe u ishin drejtuar vendeve të Bashkimit Evropian të cilat u organizuan në pritjen e refugjatëve të luftës duke ngritur kampe dhe duke krijuar infrastrukturën e nevojshme.

Pjesa më e madhe e shqiptarëve të Kosovës u vendos në territorin e shtetit amë, në Shqipëri. Ashtu siç e përmendëm më lart, lëvizja e popullsisë ishte filluar që në vitin 1998, ku shikoheshin lëvizjet e para dhe për këtë shteti shqiptar kishte filluar të merrte masa për t'u përgatitur për një valë të madhe refugjatësh. Gjithashtu, gjatë periudhës prill-gusht të vitit 1998 Kuvendi i Shqipërisë kishte miratuar edhe dy rezoluta për çështjen e Kosovës.

Shqipëria, sado e gjendur në kushte shumë të vështira ekonomike, pasi sapo kishte dalë nga viti i mbrapshtë 1997, dhe po përpqej t'i sanonte të gjithë pasojat që ky vit sollë, paralelisht filloi dhe përpjekjet që të siguronte të ardhura dhe vende se ku do të mund t'i strehonte refugjatët e luftës. Kështu, në tetor të vitit 1998, duke parë zhvillimet e ngjarjeve në Kosovë, dhunën dhe represionin ushtarako-policor serb, përveç fondeve të planifi-kuara nga buxheti i shtetit, Shqipëria u përpoq të siguronte të ardhura, ndihma, medikamente edhe nga donatorët e huaj për ta përballuar këtë krizë humanitare. Këto ishin çështje shumë urgjente për t'u zgjidhur pasi ende nuk ishin strehuar të gjithë personat që gjendeshin në Shqipëri për shkak të shumë vështirësive. Qeveria e Republikës Federale Gjermane ishte nga të parat që ndihmoi Shqipërinë. Në këtë situatë ajo miratoi një ndihmë prej rreth 5 mln DM të cilat do të përdoshin për rregullimin e godinave për t'i sistemuar personat e ardhur nga Kosova. Duke qenë se këto fonde nuk ishin të planifikuara, atëherë autoritetet gjermane miratuan përdorimin e fondit për ndërtimin e ujësjellësit të Korçës i cili ishte finan-cuar po nga ata dhe pranuan se ky fond do të ishte i vlefshëm për vitin 1999.

Situata emergjente në lidhje me lëvizjen e refugjatëve u bë nga marsi i vitit 1999 ku pati një vërshim të njerëzve drejt kufirit me

Shqipërinë, aty ku sigurisht kufiri ishte i hapur dhe grupe të ngritur nga qeveria me mbështetje të UNCHR-së dhe organizatave të tjera ndërkombëtare ishin në pritje të tyre. Çështja filloi të bëhej më serioze nga gjysma e dytë e marsit, pasi pati një vrull të madh refugjatësh në kufi dhe Kukësi, qyteti i parë pritës, ishte jashtë kapaciteteve të tij për ta përballuar këtë situatë. Megjithëse qeveria shqiptare kishte bërë disa përgatitje për të përballuar valë të mëdha refugjatësh, ajo çka po dukej se do të vinte në ditët e fundit të marsit ishte përtej kapaciteteve. UNHCR kishte asistuar në çdo lëvizje të qeverisë për sistemimin dhe përgatitjen e terrenit për strehimin e refugjatëve. Në bazë të situatës emergjente të krijuar, qeveria shqiptare ishte në mbledhje të vazhdueshme në çdo periudhë të ditës për ta zgjidhur sa më shpejt këtë emergjencë. Në mbledhjet e qeverisë të datave 25-27 mars u diskutua shumë në lidhje me kapacitetet që kishte vendi dhe se ku do të strehoheshin refugjatët, gjendjen e furrave të bukës dhe se sa bukë mund të prodhohin, gjen-djen e grurit në depot e rezervave të shtetit dhe se si mund të transportohej në zonat ku kishte më shumë nevojë, problemin e transportit të refugjatëve etj. Gjendja filloi të ishte serioze ku brenda ditës arritën në kufi rreth 10 mijë refugjatë dhe numri i tyre shtohet nga ora në orë. Kjo alarmoi të gjithë komisionet e ngritura për përbalimin e situatës së emergjencës pasi numri sa vinte dhe rritej dhe zona të tëra nga Rahaveci, Suhareka dhe Prizreni ishin nisur drejt kufirit. UNHCR, në bashkëpunim me qeverinë shqiptare, mori angazhim për ngritjen e kampeve dhe çadrave jashtë Kukësit, pasi ky i fundit ishte tejmbushur. Qeveria shqiptare kishte përcaktuar disa terrene se ku mund të vendoseshin refugjatët duke specifikuar ato me mundësinë më të madhe të akomodimit si Mamurras (ku do të krijohej një qytezë) dhe Kepin e Rodonit të cilin e kishte propozuar UNHCR. Gjithashtu, u morën në konsideratë edhe qytetet e tjera të cilat kishin kapacitete për të strehuar dhe për të përgatitur terren për strehimin e shumë personave të tjerë. Fieri dhe Elbasani ishin qytetet të cilat mund të strehoheshin përtej numrit 2 000, për më tepër në mbledhjen e qeverisë u diskutua edhe për zonat të cilat kishin mundësi të akomodonin sadopak edhe 100 apo 200 refugjatë. Më 1 prill 1999 u vendos për krijimin e një kampingu në Durrës, në zonën e Spitalles, me një sipërfaqe prej 40.6 ha, sipërfaqe kjo që ishte përcaktuar për banorët të cilët ishin përmblytur nga Liqeni i Fierzës.

Për shkak të këtyre vështirësive u shpall gjendja e jashtëzakonshme

në prefekturat: Kukës, Shkodër, Lezhë dhe Dibër, por në mbledhjen e qeverisë u diskutua dhe mbeti e hapur mundësia për ta shpallur këtë gjendje dhe në pjesë të tjera të vendit që do të ndikoheshin nga kriza e refugjatëve.

Si rezultat i rritjes së vazhdueshme të numrit të refugjatëve që vinin duke u shumëfishuar nga momenti në moment, qeveria, me anë të një VKM-je, i akordoi 500 tonë grurë nga rezervat e shtetit prefekturës së Kukësit pa pagesë dhe me shpenzimet e transportit të mbuluara nga Drejtoria e Për-gjithshme e Rezervave të Shtetit. Gjithashtu, në fillim të prillit u vunë në dispozicion po nga Rezervat e Shtetit rreth 120 tonë miell dhe mbi 1 000 tonë grurë. Këto të fundit ishin të gatshme për t'u transportuar në çdo moment drejt Kukësit.

Problemet e transportit ishin po kaq të rëndësishme sa edhe akomodimi apo ushqimi i refugjatëve të ardhur. Për këtë arsye, me urdhër të kryemi-nistrit, me datë 30.03.1999 u përcaktua mënyra e lëvizjes së refugjatëve dhe mënyra e transportit. Do të angazhoheshin të gjithë personat e mini-strive të cilët mund të përdornin një makinë dhe të gjithë autobusët apo mjetet private të cilat mund të transportonin udhëtarë ku shpenzimet e naftës dhe të rrugës do të merreshin nga buxheti i shtetit. Kjo ishte një lëvizje e shpejtë deri në momentin e ardhjes së mjeteve të transportit nga Italia të cilat do të ishin një frymëmarrje për qeverinë në këto momente kritike.

Nevoja e shpërndarjes së refugjatëve dhe ushqimi i tyre ishin sfidat më të mëdha përpara të cilave qeveria shqiptare gjendej. Mund të themi se nga të dhënat e paraqitura në mbledhjet e qeverisë me datë 29 mars gjendeshin në qytetin e Kukësit rreth 66 mijë persona, një pjesë e të cilëve nuk kishin mundur të akomodoheshin. Pjesa më e

madhe e furnizimeve ishte 2-3 ditore me produktet bazë, bukë, vaj, sapun, mish, konserva etj., shpërndarja e të cilave ishte një sfidë tjetër pasi gati të gjitha makinat në pronësi të shtetit ishin të përqendruara në shpërndarjen e refugjatëve në qytete të ndryshme të vendit sipas numrave që ato qytete mund të akomodonin. Në fillim të prillit numri i mjeteve të transportit sa vinte e rritej dhe brenda pak ditësh, arriti në 110 autobusë dhe mikrobusë brenda një dite të cilët transportonin vetëm njerëz në drejtim të prefekturave që ishin caktuar, nga ku merrnin shpërbalimin e tollonave të naftës të cilët, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave, plotësoheshin nëpërmjet blerjes së tyre në Albpetrol (bëhet fjalë për mjetet private). Përpos këtyre mjeteve u vunë në dispozicion për të transportuar refugjatët edhe kamionë, zeturë, vetura, furgonë dhe trena deri aty ku mund të arrinin nga zona e përqendruar e refugjatëve.


Strukturat e shëndetësisë, të paktën në zonën e Kukësit ku u shpall dhe gjendja e jashtëzakonshme, kanë qenë gjatë gjithë kohës në krye të detyrës duke dhënë ndihmesë shumë të madhe në këtë krizë humanitare. Personeli shëndetësor u përqendrua në verifikimin e vendit pasi struktura vendase nuk mund ta përballonte fluksin dhe pati ndihmesë sigurisht edhe nga Organizata Ndërkombëtare si Kryqi i Kuq, Caritasi, Mjekët e Botës etj. E gjithë struktura shëndetësore në kujdesin e komisionit qeveritar për përbalimin e kësaj krize arriti me sukses të shmange një fatkeqësi të madhe si sëmundjet epidemike, gjë e cila ishte diskutuar që mund të ishte një problem dhe do të shkaktonte pasojat të jashtëzakonshme pasi shtetet fqinje menjëherë do t'i mbyllnin kufijtë.

Përveç kësaj, qeveria kishte marrë

masa duke përcaktuar edhe mënyrën se si do të zhvillohej mësimi, duke përcaktuar numrin e nxënësve, numrin e klasave, mësimet bazë dhe ambientet se ku do të zhvillohej ky proces kaq i rëndësishëm. Gjithashtu, u krijuan struktura për t'i ndihmuar kryesisht gratë dhe fëmijët për t'i tejkuluar traumat që lufta apo situata aktuale i kishte sjellë. Kjo nismë ishte nga më pozitive për përbalimin e situatës dhe kuj-desin e shëndetit mendor dhe gjendjes psikologjike të njerëzve.

Me gjithë këto vështirësi, në raportin përfundimtar të UNHCR-së thuhet se Shqipëria e përballoi shumë mirë situatën me refugjatët e luftës në bazë të mundësive që vendi kishte. Këtu duhet theksuar edhe ndihma shumë e madhe e popullit shqiptar i cili strehoi në shtëpitë e veta familje të tëra nga Kosova. Duhet ta theksoj edhe ndihmën e vendeve aleate, ShBA-së, Gjermanisë, Italisë, Turqisë, Greqisë etj., që arritën të sillnin, në një kohë rekord, të ardhura, mallra, medikamente, mjete dhe ushqime për ta përballuar këtë krizë humanitare. Interesant është fakti që Japonia ka dhënë një ndihmë shumë të madhe për përbalimin e pasojave të kësaj krize që Shqipëria po kalonte.

(Marrë nga libri "Ushtria Çlirimtare e Kosovës, vlerë kombëtare", botuar nga Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kjo kumtesë është paraqitur në sesionin shkencor mbajtur në Prishtinë më 7 mars 2022, organizuar nga: Instituti Albanologjik i Prishtinës, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave e Shqipërisë dhe Agjencia Shtetërore e Arkivave e Kosovës. Kumtesat e njëzet intelektualëve shqiptarë gazeta "Epoka e re", përpos në portal, do t'i botojë për njëzet ditë me radhë edhe në formatin pdf. Librin mund ta gjeni në Agjencinë Shtetërore të Arkivave të Kosovës.)



FJALIM NË CEREMONINË SOLEMNE TË VËNIES SË GURTHEMELIT PËR SHTATOREN E TRIBUNIT TË KOMBIT RAMIZ CERNICA!

RAMIZ CERNICA DEPUTETI HISTORIK I POPULLIT SHQIPTAR



Ismet SYLEJMANI

*E nderuara familje e Tribunit të Kombit Ramiz Cernica,
Të dashura familje të Heronjëve dhe Dëshmorëve të Kombit,
I nderuar Kryetar i Gjilanit z, Alban Hyseni,
I nderuar Kryesues i Kuvendit z. Arianit Sadiku,
I dashur Udhëheqës i popullit shqiptar Ali Ahmeti,
Të nderuar shokë e bashkëvprimtar nga të gjitha anët,
Të nderuar deputet të Parlamentit të Kosovës,
I nderuar Zëvendësministër i Mbrojtjes të Kosovës, z. Shemsi Sylja,
I nderuar Zëvendësministër i Punëve të Brendshme të Maqedonisë së Veriut, z. Nazim Bushi,
I nderuar Kryetar i Klubit Politik "Afrim Zhitia" z. Ragip Shala,
Të dashur fshatarë të Cernicës,
Të nderuar të pranishëm,
Zonja dhe zotrinj!*

Sot po shenojmë një ngjarje me rëndësi të madhe historike!
Në Gjilan këtu përpara ndërtesës të

Komunës, po vendosim gurthemelin e shtatores së Deputetit të popullit shqiptar në Kuvendin e Prizrenit, Tribunit legjendar të Kombit tonë, Ramiz Cernica!

Për të nderuar këtë gjigand për qëndrimin e Tij madhor e me dinjitet të lartë kombëtar dhe me guxim epik të pashembullt, sot jemi tubuar i madh e i vogël, dhe nga të gjitha anët e Atdheut të Skenderbeut kemi ardhur këtu!

Kanë ardhur shqiptar nga Amerika e atdhetar të devotshëm!

O Ramiz Cernica!

O deputeti historik i kombit tonë!

Ti qe je bërë pjesë e dheut dhe qiellit të Atdheut, sot pas 77 viteve, të qëndrimit Tënd të pashembullt në parlamentin e pas Luftës së Dytë Botërore të Kosovës në Prizren, po vendoset gurthemeli për shtatoren Tënde gjigante, dhe biri i madh dhe i shquar i kombit tonë, një pasardhës besnik i heroizmit masiv të Atdheut të shqiptonjave, në mesin tonë është themeluesi i tri ushtrive çlirimtare, është Udhëheqësi i popullit shqiptar Ali Ahmeti!

Kanë ardhur këtu për të nderuar Tribunin e Kombit Ramiz Cernica, ata të cilët janë të shumtë dhe janë emra të njohur e figura të shquara, kontributi i të cilëve është kolosal!

Janë të shumta zemrat e mëdha shqiptare dhe mendjet e ndritura të kombit, të cilat te Heroi i Kuvendit të Kosoves në Prizren, e kanë pasur simbolin e famshëm, i cili kishte pasur aq shumë guxim të tillë njerëzor, sa në mes të Parlamentit, ju

kishte thënë pushtuesve serb dhe tradhëtarëve shqiptar, se e keni gabim dhe do të vijë koha e do të dilni të mundur e të humbur, se Kosova kurr nuk do të mbetet nën Serbi, por do të luftohet e do të derdhet gjak dhe Kosova do të jetë e lirë dhe dhe do të jetë me Shqipërinë!

Ushtria Çlirimtare e Kosovës, gjaku i derdhur për liri e çlirim i Heronjeve dhe Dëshmorëve të Kombit, veteranët dhe atdhetarët e ndryshëm, ndihma e madhe e Nënës Shqipëri, ndihma e madhe e NATO-s dhe veçanërisht e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, kanë bërë realitet qëndrimin titanik të deputetit legjendar të popullit shqiptar, i cili para 924 muajve apo përpara 28,105 ditëve, paralajmëronte se Kosova nuk

është e Serbisë, por është e Nanës së sajë e Shqipërisë!

Pas 54 viteve të qëndrimit të Tij heroik, më 12 Qershor 1999, Serbia pushtuese kapituloi, dhe u largua nga Kosova!

U bë realitet qëndrimi i tij!

Ja sa i madh e i pashembullt ishte gjeniu largpamës Ramiz Cernica!

Sot pas pak, do të vendosim gurthemelin, dhe nga sot do të fillojmë të numrojmë ditët dhe netët, javët dhe muajtë dhe më në fund do ta kemi edhe shtatin e derdhur në bronz të Simbolit të bashkimit me Shqipërinë, Tribunin e Kombit Ramiz Cernica!

Lavdi e përgjeshme Deputetit legjendar të popullit shqiptar Ramiz Cernica!

Gjilan, 25 Nëntor 2022!



EURO GLASS
 SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON Envert
 Adr: Fushë Kosovë
 Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
 E-mail: euro.glass@live.com

Sport

**QENDRA SPORTIVE
 'BUJQËSIA'
 TEL: 045/82 82 82**

Jona Beqiri: Synoj suksese në Kampionatin Evropian dhe Botëror, pse jo në Olimpiadë

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Jona Beqiri është një prej sportistëve më të mira në Kosovë. Jona merret me sportin e notit që nga mosha nëntëvjeçare dhe deri tash ka arritur shumë suksese në rrafshin vendor dhe në atë ndërkombëtar, duke fituar mbi 200 medalje dhe shumë diploma, kurse synimet

interes, por me kalimin e kohës më është dhënë mundësia për ta shprehur talentin tim falë angazhimit të pakursyer të trajnerëve të mi në klubin e notit "Step" në Prishtinë, të cilët e kanë vrenjtur talentin tim dhe i falënderoj për zemërsisht për punën dhe angazhimin e tyre të pakursyer. Posaçërisht e falënderoj trajnerin tim Besart Shala që m'i mësoi hapat e parë të

sport u rritën, duke ushtruar në mënyrë më rigoroze. Viti 2015 ishte shumë i begatshëm për mua, sepse unë fillova me not, por edhe mora pjesë në një garë në Prishtinë, e cila ishte organizuar nga Federata e Notit të Kosovës dhe në atë garë e kam fituar medaljen time të parë nga bronzi.

"Epoka e re": E përmendët që jeni pjesë e Klubit të Notit "Step" në Prishtinë. Që sa kohë jeni pjesë e këtij klubi dhe cilat janë kushtet që ofron klubi për këtë sport?

Beqiri: Unë jam pjesë e Klubit të Notit "Step" në Prishtinë. Aty fillova hapat e parë, në moshën nëntë vjeçe dhe vazhdoj ende me këtë sport. Pra, tani po bëhen shtatë vjet që ushtror dhe nuk kam pasur asnjë mungesë në klub.

"Epoka e re": Cilat janë sukseset më të mëdha të arritura deri tash?

Beqiri: Sukseset e mia me këtë sport janë të shumta, por do t'i veçoja disa: pjesëmarrja në garat e Kampionatit Evropian, të mbajtura në vitin 2021, në Budapest të Hungarisë. Në këto gara unë isha përfaqësuese e reprezentacionit të Kosovës në garat për të rritur (senior). Gara tjetër ishte në Romë të Italisë. Aty u mbajt Kampionati Evropian për të Rinj (Juniorë). Këto dy pjesëmarrje të cilat i përmenda më sipër kanë qenë të një konkurrence të fortë dhe shumë sfiduese për mua, sepse këtu ka pasur sportiste të nivelit botëror dhe për mua ishte hera e parë. Ndërsa në garat vendore dhe rajonale isha pjesëmarrëse në Shqipëri, Maqedoni të Veriut, Mal të Zi, Kroaci dhe Bullgari. Nga këto vende kam arritur të fitoj me dhjetëra medalje të arta nga të gjitha disiplinat e notit. Kam fituar shtatë kupa. Tri prej kupave janë të nivelit absolut. Në dhomën time kam mbi 200



medalje dhe shumë diploma nga rezultatet e mia. Tri herë kam qenë fituese multimedaliste e turneve të ndryshëm. Pjesë e sukseseve të mia që lexuesit kanë dëshirë t'i lexojnë në këtë vit (2022) janë: arritja dhe mbajtja e katër rekordeve në Republikën e Kosovës në katër disiplinat e notit të cekura më poshtë:
 -200 m shpinë – 02:19:41
 -100 m Mix – 01:07:77
 -200 m Mix – 02:26:17
 -400 m Mix – 05: 23:79
 Në garat e mbajtura gjatë këtij vikendi në turneun "Kosovo Cup", të organizuar nga Klubi i

Notit "Step" në Prishtinë, kam arritur ta fitoj kupën përsëri.

"Epoka e re": Sukseset e gjertanishme në karrierën tuaj nuk janë të vogla. Sigurisht që synoni t'i vazhdoni këto suksese edhe në të ardhmen, por cila është ëndrra juaj më e madhe në karrierë?

Beqiri: Si çdo sportist që synon më të mirën për veten e tij, edhe unë synoj që në të ardhmen ta fitoj ndonjë garë në Kampionatin Evropian apo Botëror, pse jo edhe atë në Lojërat Olimpikë.



për të ardhmen i ka edhe më të mëdha. "Si çdo sportist që synon më të mirën për veten e tij, edhe unë synoj që në të ardhmen ta fitoj ndonjë garë në Kampionatin Evropian apo Botëror, pse jo edhe atë në Lojërat Olimpikë", ka thënë Beqiri në intervistë për "Epokën e re".

"Epoka e re": Jona, në cilën moshë keni filluar të merreni me sportin e notit?

Beqiri: Me sportin e notit kam filluar të merrem nga mosha nëntëvjeçare. Në fillim ia kam nisur vetëm për relaksim, "hobi", sa për ta kaluar kohën e lirë. Kjo ishte edhe dëshira e prindërve të mi që të merrem not. Pas disa muajve me ushtrime, ky sport filloi të më hyjë në zemër.

"Epoka e re": Noti nuk është ndër sportet elitare në vendin tonë, por nga ju lindi dashuria për notin?

Beqiri: Dashuria për notin më ka lindur shumë spontanisht. Nuk kam menduar asnjëherë që do të bëhem notare apo do të merrem me këtë sport. Në fillim, ushtrimet e notit nuk më dukeshin me

notit. Me sportin e notit, menjëherë pas katër muajve ushtrime, fillova t'i shoh ndryshimet e mia pozitive në zhvillimin e trupit tim, por edhe në relaksimim tim shpirtëror. Asnjëherë nuk e kam pasur në mendje që të marr pjesë në gara, por mendimi im ndryshoi shumë shpejt, vendosa të jam edhe unë pjesë e konkurrencës. Më pastaj plani dhe ambiciet e mia për këtë



Ermal Krasniqi, 'Ylli i Javës' në Superligë

PRISHTINË, 29 NËNTOR - Federata e Futbollit e Kosovës së bashku me sponsorin e Superligës, Albi Mall, vazhdojnë ta japin çmimin "Ylli i Javës" pas çdo xhiroje në Albi Mall Superligë. Çmimi i më të mirit për javën e 18 i ka takuar futbollistit të FC

Ballkani, Ermal Krasniqi. Komisioni vlerësoi se sulmuesi anësor i kampionëve në fuqi ishte më i merituari në fitoren si mysafir ndaj Gjilanit me rezultat 3:0. Ai përgjatë tërë ndeshjes tregoi lojë të mirë, derisa ishte vendimtar në arkëtimin e tri pikëve të

reja edhe me dy gola të shënuar. "Si çdoherë është kënaqësi të zgjedhësh më i miri i javës. Ndjenjë e mirë që u riktheva prapë gjatë këtij edicioni për ta marrë këtë shpërblim. Jam i lumtur për sukseset e klubit dhe për faktin që arrij ta ndihmoj

skuadrën nga ndeshja në ndeshje në arritjen e objektivave të saj. Ballkani edhe në këtë edicion po tregon seriozitetin dhe jemi në rrugën e duhur për ta mbrojtur titullin kampion. Falënderoj bashkëlojtarët, trajnerët dhe të gjithë stafin,



pasi bashkërisht po bëjmë një punë të mrekullueshme", ka thënë Krasniqi.

Kupa e Botës: Angli - Senegal dhe Holandë - Amerikë

DOHA, 29 NËNTOR - Anglia është kualifikuar për në fazën tjetër të Botërorit si e para në grup. Kombëtarja e "tre luanëve" mundi 0-3 Uellsin, në një sfidë që nuk ishte aq e lehtë. Goli i parë i ekipit të Southgate erdhi në fillimin e pjesës së dytë, me anë të Rashford. Goli i sigurisë mban firmën e Foden, menjëherë më pas. Spektakli nuk mbaroi me aq, pasi Rashford do gjente sërish rrjetën. Anglia e mbyll fazën e grupeve me 7 pikë në vendin e parë (do luajë ndaj Senegalit), me dy fitore dhe një barazim. Pas Anglisë edhe Amerika e ka siguruar një vend për në 16 më të mirat e Kupës së Botës në Katar. Angli-Senegal dhe Holandë-Amerikë do të jenë përballjet e fazës tjetër. Amerikanët morën një fitore

minimale 1-0 në duelin direkt ndaj Iranit. Rezultatit e vulosi një gol i shënuar nga ylli i Chelseat, Christian Pulisic në minutën e 38-të. Në pjesën e dytë, Amerika ruajti mjaft mirë rezultatit dhe siguroi kualifikimin. Siç dihet Senegali mori një fitore të madhe 2-1 ndaj Ekuadorit duke siguruar kalimin për në turin tjetër. Ismaila Sarri zhbllkoi rezultatit në fundin e pjesës së parë me penallti. Ekuadori u zgjua në pjesën e dytë duke barazuar me Moises Caicedo, por gëzimi i tyre zgjati vetëm dy minuta, pasi Koulibaly do të realizonte një gol fantastik. Holanda mori një fitore të thjeshtë 2-0 ndaj Katarit, duke blinduar vendin e parë. Gakpo dhe De Jong shënuan golat e fitores.



Sfida interesante në Ligën Unike të Femrave



PRISHTINË, 29 NËNTOR - Në mesjavë do të zhvillohet xhiroja e dytë në Ligën Unike të Femrave. Në xhiron e parë fitore shënuan skuadrat nga Shqipëria në tri përballjet ndaj atyre të Kosovës. Takimi i parë zhvillohet ndërmjet Bashkimit dhe Prishtinës, që pritet të jetë shumë interesant, për faktin se të dyja skuadrat kanë ambicie të mëdha në këtë edicion. Vashat prizrenase nuk

kanë pësuar asnjë humbje në Superligën e Femrave në Kosovë, kurse ato prishtinase janë kampione të Ligës Unike dhe synojnë mbrojtjen e titullit. Në këtë edicion janë përballur një herë, në Superligën e Femrave, ku fituan prizrenaset 75:65. Përballja e dytë zhvillohet në mes të Flamurtarit dhe Penzës në Vlorë. Skuadra vlonjate e ka nisur me fitore dhe, gjithashtu, e fitoi

Superkupën Mbarëkombëtare, trofe që një edicion më herët e kishte fituar skuadra pejane. Sfida në mes të kampiones së Shqipërisë dhe Kosovës pritet të jetë shumë interesante. Ndeshja e fundit zhvillohet ndërmjet skuadrave tiranase Partizanit dhe Tiranës, që e nisën edicionin e ri me fitore dhe shpresojnë ta vazhdojnë serinë pozitive.

Lakersat humbasin në sekondën e fundit, fitore për Bostonin dhe Phoenixin

LOS ANXHELOS, 29 NËNTOR - Skuadra e lakersave u ndal sot nga Indiana, që fitoi me rezultat 116-115 në sekondën e fundit. Haliburton me 24 pikë e Mathurin me 23 i dhanë fitoren ekipit mik, duke i bërë të pavlefshme 25 pikët e 13 reboundet e Davisit për kalifornianët. Jashtë fushës fiton Chicago, që mundi Utah Jazz (114-107), ndeshje ku u dallua DeRozan, autor i 26 pikëve.

Bostoni vijon të jetë skuadra më e mirë në NBA këtë sezon, me 17 fitore. Celticsi fitoi sot 140-105 ndaj Charlottes, sfidë ku diferencën e bëri Tatum me 35 pikë. Në Perëndim kryeson skuadra e Phoenixit, që mundi me rezultat 122-117 Sacramento, me Bookerin protagonist, autor i 44 pikëve. Ndërsa Denveri, falë 32 pikëve e 12 reboundeve të Jokiçit, mundi Houstonin (129-113).

REZULTATET

Washington - Minnesota	142-127
Boston - Charlotte	140-105
Brooklyn - Orlando	109-102
Toronto - Cleveland	100-88
New Orleans - Oklahoma	105-101
Denver - Houston	129-113
Utah Jazz - Chicago	107-114
Sacramento - Phoenix	117-122
Lakers - Indiana	115-116



Verstappeni konfirmon: Garoj sërish me numrin 1

Piloti holandez Max Verstappen, kampion bote në Formula 1, ka konfirmuar se do ta mbajë sërish numrin 1 në makinën e tij. Verstappeni ka mbajtur dikur numrin 33, por

vjet kaloi në numrin 1, të cilin do ta mbajë edhe këtë sezon. "Po, do të garoj sërish me numrin 1", u shpreh piloti holandez i Red Bullit. "Për mua është numri më i mirë i

mundshëm me të cilin do të garoj për sa kohë kam mundësi. Nuk ndodh gjithnjë që të mbash këtë numër, që i takon vetëm kampionit të botës", ka thënë Verstappen.

"Për sa kohë do të jem kampion dhe do ta mbroj titullin, nuk do ta ndryshoj numrin 1. Numrin 33 mund ta përdor sa herë të kem dëshirë. Unë synoj që edhe vitin tjetër të

jem kampion bote. E di që do të jetë një sezon më i fortë, por unë garoj për fitore dhe për ta nderuar numrin 1 të kampionit", ka deklaruar Verstappen.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË SH.A

Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, Ligjin Nr. 03/L-212 i Punës konkretisht Neni 8, Rregullorën Nr. 23/2020 për Procedurat e Punësimit, Strukturën Organizative, Kategorizimin dhe Përshkrimin e vendeve të punës në KMDK SH.A, Udhëzimin Administrativ (MPMS) Nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik dhe bazuar në Vendimin e Kryeshefit Ekzekutiv të KMDK SH.A me Nr. 115/2022 me numër të protokollit 02-09/115, KMDK SH.A shpall këtë:

KONKURS PUBLIK (PËR PLOTËSIMIN E VENDIT TË PUNËS)

Titulli: Ngasës i Makinerisë së Rëndë /Manipulator – 1 (Një) Pozitë

Numri i Referencës: ZP/KJ-6-2022

I raporton: Përgjegjësit të Deponisë Sanitare

Niveli i pagës: VIII

Orët e Punës: 40 orë në javë

Kohëzgjatja e kontratës: Me kohë të caktuar (1 vit) me mundësi vazhdimi

Vendi i punës: Deponia Sanitare, Landovicë, Prizren

Detvrat dhe përgjegjësitë:

- Të respektojë Udhëzimet e dhëna nga Përgjegjësi i deponisë dhe Inxhinieri i Makinerisë lidhur me përdorimin e makinerisë;
- Ti respektojë rregullat dhe udhëzimet e përcaktuara për makinerinë e rëndë;
- Ti respektojë rregullat e caktuara të komunikacionit;
- Të jetë fleksibil në punë, të jetë i gatshëm të punojë nën presion dhe në kolektiv;
- Para çdo vojitje të bëjë kontrollimin e gjendjes së makinerisë;
- Të njoftojë për çdo defekt të makinerisë tek Përgjegjësi i deponisë;
- Pas çdo përdorimi të bëjë kontrollin, pastrimin dhe ta kthejë makinerinë në vendin e caktuar;
- Kryen edhe punë të tjera sipas kërkesës së PD;
- Për punën e vet jep përgjegjësi, Përgjegjësit të deponisë.

Kualifikimet:

- Diploma e shkollës fillore.
- Minimum 1 vjet përvojë pune.

Aftësitë krvesore

- Të posedojë Patentë Shoferë të kategorisë përkatëse.

Procedura e konkurimit

Kandidatët e interesuar, formularin zyrtar mund ta marrin në zyrë e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A apo ta shkarkojnë nga web faqja e internetit në adresën: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacionin mund ta paraqesin në kopje fizike në zyrë e Burimeve Njerëzore në adresën: Rruga "Bekim Fehmiu" Nr. 137, 10000 Prishtinë, Kosovë (Afër Shkollës Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Tel: 038/ 600 – 552.

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- CV,
- Diploma,
- Certifikatat mbi kualifikimet dhe trajnimet,
- Dëshmi mbi përvojën në punë, si dhe dëshmi të tjera në bazë të kualifikimit dhe aftësive.

Shënim: Aplikacionet e dërguara me postë, të cilat mbajnë vulën postare mbi dërgesën e bërë ditën e fundit të afatit për aplikim, do të konsiderohen të vlefshme dhe do të merren në shqyrtim nëse arrijnë brenda tri (3) ditësh. Aplikacionet që arrijnë pas këtij afati dhe ato të pa kompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

Afati për aplikim është 15 ditë nga dita e publikimit të Konkursit të Jashtëm në Gazetat/Platformat Elektronike dhe Web-Faqe të KMDK-së, duke filluar nga data: 30.11.2022 deri me datën 14.12.2022 ora 08:00-16:00.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Zyren e Burimeve Njerëzore të KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Tel: 038/ 600 – 552.



Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë Sh.A.
Kosova Landfill Management Company J.S.C
Rr. Bekim Fehmiu 137, Lakrishtë, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: +383 (0) 38 600 551; 600 552
www.kmdk-ks.org

Na osnovo Zakona br. 03/L-087 za javna preduzeća, Zakon br. 03/L-212 o radu, posebno član 8 Uredbe br. 23/2020 o postupku zapošljavanja, organizacionoj strukturi, kategorizaciji i opisu poslova u KMDK S.A., Administrativno uputstvo (MPMS) br. 07/2017 o uređenju postupaka za zasnivanje radnog odnosa u javnom sektoru i na osnovu Odluke od glavni izvršni direktor KMDK SH.A sa br. 115/2022 sa protokolom broj 02-09/115 KMDK dd saopštava:

JAVNI KONKURS

(ZA POPUNJAVANJE RADNOG MESTA)

Naziv: Vozač/manipulator teških mašina – 1 (jedna) pozicija

Referentni broj: ZP/KJ-6-2022

Izveštava: Upravitelj sanitarne deponije

Visina plate: VIII

Radno vrijeme: 40 sati sedmično

Trajanje ugovora: Na određeno vremena (1 godina) sa mogućnošću produženja

Mesto rada: Sanitarne deponije-Landovicë, Prizren

Dužnosti i odgovornosti:

- Da poštuje uputstva koja su dali upravnik deponije i mašinski inženjer vezano za upotrebu mašina;
- da poštuje pravila i uputstva definisana za teške mašine;
- Morate poštovati određena saobraćajna pravila;
- Da bude fleksibilni na poslu, spremni za rad pod pritiskom i u timu;
- Provjeriti stanje mašine prije svake vožnje;
- Obavestiti upravnika deponije o bilo kakvom kvaru mašine;
- Nakon svake upotrebe provjerite, očistite i vratite mašinu na predviđeno mesto;
- Obavlja i druge poslove po zahtjevu DP;
- Odgovornost za svoj rad daje upravniku deponije.

Kvalifikacije:

- Diploma osnovne škole.
- Minimalno 1 godina radnog iskustva.

Ključne vještine

- Posjedovati vozačku dozvolu odgovarajuće kategorije.

Konkursna procedura

Zainteresovani kandidati mogu dobiti zvanični formular u kancelariji za ljudske resurse KMDK SH.A ili ga preuzeti sa web stranice na adresi: <https://kmdk-ks.org/>. Dokumentacija se može dostaviti u fizičkoj kopiji kancelariji za ljudske resurse na adresi: ulica „Bekim Fehmiu“ br. 137, 10000 Priština, Kosovo (blizu škole Shtjefën Gjeçovi), Lakrishtë. Telefon: 038/ 600 – 552.

Kandidati koji se takmiče moraju ispravno unijeti adresu, kontakt telefon i email adresu. Samo odabrani kandidati će biti pozvani na dalje procedure zapošljavanja.

Potrebna dokumentacija:

- životopis
- stepen,
- Sertifikati o kvalifikacijama i obuci,
- Dokaz o radnom iskustvu, kao i drugi dokazi na osnovu kvalifikacija i vještina.

Napomena: Prijave poslate poštom, koje su obilježene poštanskim žigom posljednjeg dana roka za prijavu, smatrat će se valjanim i bit će uzete u obzir ako stignu u roku od tri (3) dana. Prijave koje pristignu nakon ovog roka i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

Rok za prijavu je 15 dana od dana objavljivanja Eksternog konkursa u novinama/platformama i elektronskim stranicama KMDK, počev od: 30.11.2022. do 14.12.2022, 08:00-16:00 sati.

Za detaljnije informacije možete se obratiti Službi za ljudske resurse KMDK SH.A

Email: info@kmdk-ks.org

Telefon: 038/ 600 – 552.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Optika You and Eye” SH.P.K. Gjilan me prona Visar Huruglica, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811472589 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Optika You and Eye” D.O.O. Gnjilane, Visar Huruglica, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811472589 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Optika You and Eye” L.L.C. Gjilan, Visar Huruglica, has come to the decision to quit its business: 811472589 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se “BEG Balkan Export Group” – L.L.C, ka marrë vendim të shuajë biznesin me NUI: 811550111 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë me këtë kompani që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “BEG Balkan Export Group” - d.o.o., donelo odluku o prestani rada sa bisnisom NUI: 811550111 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all clients that “BEG Balkan Export Group” - L.L.C, has taken the decision to quit its business with NUI: 811550111, The company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have creditor – debtor accounts with this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Gona” SH.P.K. me pronar Mejreme Isufi ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 810129686 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Gona” D.O.O. Mejreme Isufi, donelo odluku o prestani rada sa nrb. 810129686 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Gona” L.L.C. Mejreme Isufi, has come to the decision to quit its business: 810129686 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidation process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Amide Fetahu shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme “Gjin Gazulli” Prishtinë.

- Valon Sylja nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi”.

- Valbona Tahiri nga Doli KK Gjakovë shpall të pavlefshme dëftesën e SH.F. “Anton Çeta” Dol KK Gjakovë nga kl. I-VIII.

- Feriz Micaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu "Abdyl Frasheri" Prizren.

- Salajdin Krasniqi shpall te pavlefshme diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Adonis Krasniqi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën shmlt "11 Marsi" Prizren.

- Artan Hodaj shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu "Hysni Temaj" Kushnin, Has.

- Infermierja e përgjithshme, Rabe Nikçi nga komuna Pejës me numër personal 1003700182, shpalli të humbur Licencën e Punës me numër: KO-3462-05-20, me afat prej 03.01.2018 deri 03.01.2023.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.



ROYAL CROWN
RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905

RC
cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L